



Pranimi / Dostizari Prilpjenj/Prilpjenj Received/Delivered	23. 01 2023	9	viti god Year
Organ / Institucija Organ / Institution Org / Inst	Hr Prof Br Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Shera Kolicina Quantity
SKIMSHCK	433/2024		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1441/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1441/2023 të datës 23.11.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike ‘Kontestim Konkursi’, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1441/2023 e datës 23.11.2023, e parashtruar nga ankuesi

II.MBETET NË FUQI Vendimi i datës 16.11.2023, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

Arsyetim

Komuna e Prishtinës në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, neni 34 paragrafi (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës fillimisht më datë 29.08.2023 ka njoftuar për konkursin me numër reference Nr. i Referencës RN00012433, me emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore për pozitën e punës ‘Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët’, në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës ku afati për aplikim ka qenë nga data 19.09.2023 deri më datën 29.09.2023.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Më datë 30.10.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës ka nxjerrë vendimin përmes së cilit ankuesi nuk i plotëson kriteret e parapara me konkursin për pozitën Specialistë të Shkencave Shoqërore, Nr. i Referencës RN00012433, i publikuar me datë 29.08.2023 për pranim dhe karrierë në shërbim civil, me arsyetimin se i njëjti gjatë fazës së verifikimit paraparak ka konstatuar se në konkursin e publikuar kandidati i lartëcekur nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit si në vijim: kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (Fakulteti i gjuhës angleze) dhe Certifikata nga Gjykata (jo më e vjetër se nga data e shpalljes së konkursit) nuk është bashkangjitur.

Ankuesi kundër njoftimit për listën e ngushtë, ka parashtruar ankesë me pretendimi ankimor se i plotëson kushtet e konkursit. Ndërsa me datë 16.11.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës ka nxjerrë vendimin përmes së cilit ankuesit i është refuzuar ankesa kundër njoftimit për listën e ngushtë me arsyetimin se: kandidati i lartë cekur është i kualifikuar në Fakultetin Gjuhë dhe letërsi angleze dhe nuk i plotëson kushtet e konkursit sipas kërkesave të përgjithshme formale, ku në pikën 2 kërkohet kualifikim i posaçëm në Fakultetin Juridik, Ekonomik, Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji dhe Punë Sociale.

Ankuesi i pakënaqur me datë 23.11.2023 me numër protokolli 7082/2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për mos lejimin e vazhdimit të konkurrimit për pozitën Specialistë të Shkencave Shoqërore për pozitën e punës "Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët", në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.12.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 12.12.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 28.12.2023 Kryesuesi i Këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 përmes të cilit ankesës së ankuesit A.nr.1441/2023 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 7082/2023 të datës 23.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për Y.V. të datës 20.05.2010; Pasqyrë e notave nga Kolegji AAB, për Y.V. me numër protokolli Nr.prot. A1-512/18 i datës 03.03.2018; Certifikatë nga "SKSK" për Y.Z. i dates 16.07.2016; Certifikatë nga "The European Wergeland Center" për Y.V. i dates 27.06.2015; Certifikatë nga "The European Wergeland Center" për Y.V. i dates 21.09.2017; Certifikatë nga MASHT për Y.V. i dates 15.12.2010; Certifikatë nga ECDL Kosova për Y.V. i datës 21.09.2010; Certifikatë nga "OSCE" për Y.V. i dates 27.10.2011; Certifikatë nga "ELTD" për Y.V. i datës 16.02.2010; Certifikatë nga "Usaid" për Y.V. i dates 24.04.2011; Certifikatë nga "ELTD" për Y.V. e muajit Qershor 2010; Certifikata nga "Usaid" për Y.V. i datës 23.04.2011; Referencë nga A.S. për Y.V. i datës 02.08.2011; Referencë nga L.S.R për Y.V. i datës 01.11.2010; Mirënjohje nga Universum për Y.V. i dates 25.05.2013; Kërkesë për përgjigje në ankesë e dates 08.12.2023; Përgjigje në ankesë i dates 12.12.2023; Konkurs me emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore për pozitën e punës "Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët", në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës i datës 29.08.2023; Aplikacioni i Y.V. i dates 26.09.2023; Vërtetim nga SHFMU "Tefik Çanga" për Y.V. me numër protokolli 23/161 të datës 26.06.2023; Vlerësimi i performancës për mësimdhënësin për Y.V. për vitin 2022/23 me numër

protokolli 23/169 nga SHFMU "Tefik Çanga" të datës 20.05.2023; Referencë nga Sh.O. për Y.V. me numër protokollit 23/119 të datës 14.05.2023; Pasqyrë nga Trusti për Y.V. për periudhën 24.05.2022-23.05.2023; Certifikatë mbi dënimet penale për Y.V. të datës 26.05.2023; Vërtetim nga "Universum" për Y.V. me numër Nr.3066/1 të datës 22.11.2016; Vërtetim nga Sh.O. për Y.V. i datës 14.05.2023; Certifikatë nga "Usaid" për Y.V. për muajin Prill 2013; Licencë e mësimdhënësit Y.V. me numër Nr.100013686 i datës 13.06.2013; Certifikatë nga "ERASMUS+" për Y.V. i datës 27.08.2023; Certifikatë nga Qendra për avancimin e performancës së Arsimit – "QAPA SHPK" për Y.V. për muajin Prill 2019; Certifikatë nga "Global Language Training" për Y.V. i datës 18.12.2019; Certifikatë nga "MASHT" për Y.V. për muajin Qershor 2020; Certifikatë nga "MFE-Republika e Shqipërisë" për Y.V. i datës 13.02.2023; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme të përgjithshme – Gjinnazi "Aleksandër Xhuvani" për Y.V. me numër protokollit 1227-23.06.2000 të datës 16.06.2000; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për Y.V. me numër nr.736 i datës 20.05.2010; Vendim nga Sektori i Burimeve Njerëzore - Komuna e Prishtinës i datës 30.10.2023; Vendim nga Sektori i Burimeve Njerëzore - Komuna e Prishtinës i datës 16.11.2023; Njoftim nga Sektori i Burimeve Njerëzore - Komuna e Prishtinës i datës 16.11.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Njoftim nga Sektori i Burimeve Njerëzore - Komuna e Prishtinës i datës 30.10.2023; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 7710/2023 i datës 28.12.2023; E-mail nga M.Ll. për C.Z. i datës 18.01.2024; Ankesa e ankuesit e datës 11.11.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e Y.V. i datës 11.11.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit të paraqitura në ankesë lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit me emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore për pozitën e punës "Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët", në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës ku afati për aplikim ka qenë nga data 19.09.2023 deri më datën 29.09.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka analizuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale konkretisht kualifikimet të posaçme formale për tu përfshirë në listën e ngushtë.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka konstatuar se kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër Nr. të referencës RN00012433 për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore për pozitën e punës "Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët", në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës kanë qenë:

**Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);

**Kualifikime të posaçme formale:** Fakulltetit Juridik, Ekonomik, Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale;

**Përvoja e punës së kërkuar:** Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës;

Bazuar në shkresat e lëndës del ankuesi ka të kryer studimet themelore Universitare në drejtimin e Gjuhë dhe Letërsi Angleze dhe ka marrë titullin Bachelori i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Universitetin e Prishtinës, i cili ka përfunduar me datë 20.10.2010. Andaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi nuk i ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale konkretisht kualifikimet të posaçme formale sipas konkursit me numër Nr. të referencës RN00012433 për emrin e grupit

Specialistë të Shkencave Shoqërore për pozitën e punës 'Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Ulët', në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Prishtinës, si rrjedhojë e kësaj pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara dhe nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes të vendimit të datës 16.11.2023, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 15, parafi 5, dhe 6, të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.*

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes të vendimit të datës 16.11.2023, me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit, me arsyetimin se nuk i plotëson kërkesat e përgjithshme formale, për tu përfshirë në listën e ngushtë, ka vepruar në pajtim, në pajtim me nenin 15, paragrafi 1,2,3 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë.*

Andaj, bazuar në faktet e lartë përmendura më sipër, konstatohet se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes të vendimit të datës 16.11.2023 ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1441/2023

Çlirim Zeka  
*Çlirim Zeka*  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.